

## **KUSHTET E PËRDORIMIT**

MV24® – kjo është dosja Juaj digjitale, e cila paraqet në mënyrë të qartë kontratat Tuaja të sigurimit, depozitimet e kapitalit dhe llogaritë bankare në një aplikacion, por mund të bëjë edhe më shumë. Shikojini me lehtësi në formatin PDF dokumentet e nevojshme lidhur me kontratat siç janë policat e sigurimit, ndryshimet e kontratave dhe dokumentet e tjera. Në vend të dokumenteve të pluhurosurat aplikacioni MV24® tregon informacione aktuale për kontrata si fillimi dhe fundi i sigurimit, si dhe primet. Datat dhe dokumentet e rëndësishme aktualizohet me kohë. Keni akses në të dhënat Tuaja në çdo kohë.

Kontratat Tuaja ekzistuese nuk ndryshohen, nuk ndërpriten ose rinëshkruhen me regjistrimin në aplikacionin MV24®. Mbrojtja Juaj e sigurimit nuk ndryshohet me përdorimin e aplikacionit MV24®.

### **1. Mundësitë dhe kushtet e përdorimit të MV24®**

1.1. Teknikisht aplikacioni ofrohet nga Jung, DMS & Cie. AG, Kormoranweg 1, 65201 Wiesbaden. Përdorimi i MV24® është falas për Ju.

1.2. Të drejtën e regjistrimit pa kufizim kanë persona fizikë madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

1.3. MV24® plotëson ndërmjetësimin tonë standard financiar me një menaxhim të lehtë digjital, konsultime dhe optimizime të çështjeve Tuaja financiare.

1.4. Përveç rishikimit të kontratave Tuaja financiare dhe produkteve të sigurimit MV24® ofron mundësinë të përdoret falës dhe pa angazhim një softuer (p.sh. kalkulator për krahasimin e tarifave), i cili ndihmon në kërkimin e produktit të përshtatshëm. Aplikacioni MV24® nga vet vetiu nuk mund të paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të situatës Suaj të përgjithshme. Përdorimi i softuerit tonë nuk zëvendëson konsultimin. Për një konsultim të plotë lidhuni me ne në telefon, me letër, me postën elektronike ose në bisedë personale.

1.5. Me përdorimin e softuerit tonë ne Ju ofrojmë mundësinë të kontrolloni përshtatshmërinë dhe tërësinë e kontratave Tuaja ekzistuese dhe kjo bëhet në bazë të dimensioneve objektive, gjithëpërfshirëse dhe të njohura të vlerësimit. Situata juaj personale, profesionale, aktuale dhe e ardhshme e jetës mund të devijojë nga parametrat e vendosura. MV24® dhe shërbimet e tij janë një ofertë vullnetare dhe ofrohen pa njohjen e një detyrimi ligjor. Ne rezervojmë të drejtën të kufizojmë, të ndryshojmë ose të rregullojmë mundësitë e përdorimit ose të ofertës.

1.6. Nuk lejohet përdorimi i MV24® për qëllime antiligjore (përkatësisht për larjen e parave). Nuk lejohet kopjimi i softuerit ose integrimi i tij në softuerë të tjerë; nuk lejohet shitja, dhënia me qira, ridhënia me qira, shpërndarja ose transferimi i licencës. E drejta e përdorimit ndërpritet në rast mosrespektimit të rregullave për përdorim pa qenë e nevojshme një paralajmërim.

### **2. Komunikimi elektronik**

Çdo informacion, njoftim ose deklarata të tjera transmetohen përmes MV24® ose me anën e postës elektronike në formë elektronike.

### **3. Detyrimet tuaja**

3.1. Jeni të detyruar të na ofroni formacion të vërtetë për të gjitha të dhënat që janë të nevojshme për regjistrimin dhe për përdorimin e softuerit tonë. Duhet të na njoftoni menjëherë për ndryshime (p.sh. të adresës, numrit të celularit ose adresës së postës elektronike).

Në rast dyshimi të arsyeshëm për vërtetësinë e të dhënave Tuaja (p.sh. në rast dyshimi për keqpërdorim), ne mund të ndërpresim regjistrimin Tuaj në çdo kohë. Në lidhje me ruajtjen e të dhënave jashtë marrëdhënieve tona, zbatohet deklarata jonë për mbrojtjen e të dhënave personale. Mund ta lexoni në adresë <https://www.MV24.de>.

3.2. Jeni të detyruar të mos u lejoni akses palëve të treta në emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin Tuaj për përdorimin e MV24®. Veçanërisht nuk duhet të ofroni të dhënat Tuaja të hyrjes në aplikacion, t'u sigurojini akses palëve të treta për shkak të ruajtjes së pamjaftueshme të të dhënave ose të përdorni një fjalëkalim që tashmë përdorni për shërbime të tjera. Ne ju këshillojmë të ndryshoni rregullisht fjalëkalimin Tuaj dhe të na njoftoni menjëherë në rast të keqpërdorimit dhe aksesit së paautorizuar në të dhënat Tuaja të hyrjes.

### **4. Kalkulatori**

4.1 Me ndihmën e kalkulatorëve të integruar në MV24® për krahasimin e tarifave („Kalkulatorë“) në çdo kohë falas dhe pa angazhim mund të merrni informacion për tarifatat dhe kushtet e siguruesve dhe sipas dëshirës Suaj të lidhni kontrata të sigurimit. Nëse përdorni opsionin për lidhjen e kontratës së sigurimit përmes MV24®, do të lindin marrëdhënie të ndërmjetësisë me konsulentin Tuaj.

4.2 Për përdorimin e kalkulatorit për krahasimin e tarifave duhet të futni të dhëna të ndryshme personale, që kalkulatori të llogaritë rezultatet Tuaja individuale. Kalkulatori për krahasimin e tarifave ofron gjithashtu propozime për optimizimin e sigurimeve ekzistuese. Rezultatet do t'ju dërgohen në postën elektronike të treguar prej Jush.

Futja dhe transferimi i të dhënave Tuaja personale bëhet përmes maskës së hyrjes në MV24®. Si përdorues Ju mbani përgjegjësi se të dhënat e futura janë aktuale, të plota dhe korrekte. Të dhënat jo të drejta, të pasakta ose të paplota janë në dëm të Tuaj, sepse mbi bazën e tyre nuk mund të përgatiten ose do të përgatiten informacione dhe oferta të pasakta. Nëse me paramendim dërgoni të dhëna të gabuara ose të pasakta, mund të kufizohet aksesit Juaj në kalkulator dhe në shërbimet e ndërmjetësimi dhe të jeni të detyruar të shpërbleni për dëmet e shkaktuara.

Mbi bazën e të dhënave të treguara prej Jush do të merrni nga konsulenti ynë informacion për tarifatat dhe kushtet e sigurimit dhe do t'ju ofrohet një produkt i përshtatshëm të sigurimit. Në parim, kjo bazohet në monitorimin objektiv dhe të balancuar të tregut. Por nuk ekziston detyrimi që në llogaritjet të përfshihen të gjithë siguruesit e tregut ose tarifatat e sigurimeve. Prandaj, krahasimet e propozuara nuk do të përfshijnë të gjithë siguruesit dhe / ose tarifatat e sigurimeve të ekzistuese në treg.

4.3 Në kuadrin e procesit mund ta ngarkoni përmes MV24® konsulentin Tuaj t'ju ndihmojë mbi bazën e të dhënave të dërguara prej Jush për mbrojtjen e sigurimit të zgjedhur nga Ju. Në këtë mënyrë midis Jush dhe konsulentit Tuaj përmes MV24® lindin marrëdhënie të

ndërmjetësimit të sigurimit. Konsulenti Juaj do të punojë për Ju si një broker sigurimi sipas § 34g të Rregullores së degës.

Kontrata e sigurimit lidhet vetëm ndërmjet Jush dhe siguruesit të zgjedhur nga Ju. Por, a do të lidhet kontratë me siguruesin, varet nga kushtet e siguruesit përkatës dhe vendoset vetëm nga siguruesi. As konsulenti Juaj, as MV24® kanë ndikim këtu.

Asnjë nga informacionet në kalkulator nuk duhet të merret si garanci ose premtim. Në veçanti ky nuk do të thotë as konsultim ligjor, as tatimor

Me rëndësi vendimtare për lidhjen e kontratës është vetëm propozimi konkret i siguruesit. Vetëm ai përgjigjet për përmbajtjen dhe korrektësinë e ofertës së vet. Prandaj në bazën e rrethanave individuale në rastin e veçantë propozimi konkret i siguruesit mund të dallojë nga rezultatet dhe propozimet e treguara nga kalkulatori.

## **5. Kontrata e brokerimit**

5.1. Për të krijuar dosjen me kontrata MV24® ka nevojë për brokerim.

5.2 Kontrata e brokerimit përmes MV24® për nga fusha dhe thelbi përputhet me kontratat standarde të degës për brokerat e sigurimit dhe përfshin kontratë dhe prokurë.

Lidhja e kontratës rregullon marrëdhëniet ligjore midis Jush dhe nesh. Në kuadrin e zbatimit të kontratës në parim nuk do të veprojmë aktivisht ndaj palëve të treta pa pëlqimin Tuaj ose pa konsultime me Ju.

Prokura u jep të drejtën nesh dhe palëve të treta të përdorura prej nesh të kërkojmë të dhënat Tuaja të sigurimit nga shoqëria e sigurimit, t'i digjitalizojmë për Ju dhe t'i ruajmë në aplikacionin MV24®, duke respektuar standardet më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale. Kështu kemi të drejtën të lidhim, të ndryshojmë ose të ndërpresim në emrin Tuaj kontratat e sigurimit, të marrim informacion nga institucionet e sigurimit shoqëror ose të riautorizojmë (gjithmonë pas bashkërenditjes me Ju). Tërë korrespondenca e siguruesit do të na ofrohet në kopje. Prokura na jep të drejtën të përfshijmë palë të treta në zbatimin dhe realizimin e kontratës së brokerimit. Përveç kësaj prokura na jep të drejtën të lidhim transaksione ligjore në emrin Tuaj me vetveten ose me ne si përfaqësues të palës së tretë (përfaqësim i shumëfishtë). Një model të kontratës, d.m.th. të kontratës së brokerimit dhe të prokurës mund të gjeni në [www.mv24.de](http://www.mv24.de). Kontrata lidhet për kohë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet nga Ju në çdo kohë.

5.3. Kontrata e brokerimit nënshkruhet nga Ju me nënshkrim digjital, që përputhet me nënshkrimin në dokumentin Tuaj të identitetit. Nënshkrimi vihet në ekranin e smartphonin, tabletën ose kompjuterin Tuaj, duke lëvizur gishtin ose mausin si stilolaps në fushën e caktuar në ekran.

5.4. Nuk marrim garanci, që të dhënat të cilët marrim nga siguruesi janë të pota dhe të drejta.

5.5. Nëse keni autorizuar konsulentin ose keni lidhur kontratë, atëherë përmes MV24® përveç konsultimeve dhe menaxhimit të kontratave Tuaja të sigurimit, ju keni mundësi të lidhni kontrata të sigurimit me ndërmjetësinë e konsulentit Tuaj. Për këtë qëllim MV24® bën

propozime të ndryshme, që bazohen në një numër të mjaftueshëm të produkteve të sigurimit dhe të siguruesve. Por nuk ekziston detyrimi që në analizë të përfshihen të gjithë siguruesit dhe të gjitha tarifat e sigurimit që janë të pranishëm në treg. Qëllimi i konsulentit Tuaj është t'ju ofrojë një produkt sigurimi, që t'ju përgjigjet nevojave Tuaja individuale. Për këtë arsye rekomandimet bazohen p.sh. në kritere siç janë raporti midis çmimit dhe shërbimit, besueshmëria në trajtimin e dëmeve dhe besueshmëria në partnerin e sigurimit dhe përvoja e mirë në konsultimin e të siguruarve të tjerë.

5.6 Detyrimi Juaj është të na ofroni me kohë dhe në mënyrë korrekte të gjitha të dhënat e nevojshme për zbatimin kontraktues të detyrimeve të konsultimit, menaxhimit dhe ndërmjetësimit përmes MV24®. Duhet të na njoftoni menjëherë për ndryshime ( p.sh. të adresës, numrit të celularit ose adresës së postës elektronike).

5.7 Nëse ndihma Juaj është e nevojshme në paraqitjen e deklaratave ndaj siguruesve ose palëve të tjera të treta për zbatimin e kontratës Suaj të brokerimit, më në veçanti në ndërprerjen, ndryshimin dhe përfundimin e sigurimit, detyroheni në rast kërkesë nga ne (është e mundur edhe përmes MV24®) ose nga siguruesi të parashtroni deklaratat përkatëse. Ne do t'ju ndihmojmë.

## **6. Analiza e nevojave**

6.1 Pas regjistrimit ju keni mundësi përveç dosjes së sigurimit të bëni një analizë falas dhe pa angazhim të nevojave. Mund ta përdorni analizën edhe nëse nuk krijoni dosje sigurimi.

6.2 Me analizën e nevojave mund të verifikoni në cilat sfera të jetës dispononi mbrojtje të mirë të sigurimit dhe në cilat sfera eventualisht do të keni nevojë për sigurim suplementar. Rezultati i analizës Suaj, si dhe të dhënat në të cilat bazohet, janë në dispozicionin Tuaj në seksionin Tuaj në MV24®.

Të dhënat Tuaja në kuadrin e analizës jepen vullnetarisht dhe mund të ndryshohen në çdo kohë. Të dhënat dhe rezultati i analizës i jepen vetëm brokerit Tuaj. Nuk bëhet transferim i të dhënave palëve të tjera të treta. Ju tërheqim vëmendjen në informacionin në deklaratën tonë për mbrojtjen e të dhënave personale.

6.3 Rezultati i analizës bazohet në një pyetësor dhe në të dhënat e parashtruara nga Ju. Prandaj është në interesin Tuaj që t'ju jepni përgjigje të drejtë pyetjeve.

6.4 Analiza e nevojave Tuaja jep vetëm një pasqyrë të mangësive eventuale dhe Ju ofron propozime të optimizimit. Ajo nuk angazhon dhe nuk pretendon për plotësi ose korrektesë. Nuk mund të zëvendësojë analizën gjithëpërfshirëse të nevojave Tuaja të plota në kuadrin e konsultimit individual. Për një konsultim të plotë lidhuni me konsulentin Tuaj me telefon, me letër, me postën elektronikë ose në bisedë personale.

## **7. Lidhja e kontratës së sigurimit**

7.1. Nëse na keni autorizuar dhe na keni ngarkuar përmes MV24® përveç konsultimeve dhe menaxhimit të kontratave Tuaja ekzistuese të sigurimit, keni mundësi të lidhni dhe kontrata të reja të sigurimit. Për këtë qëllim MV24® ofron propozime të ndryshme të cilat bazohen në një numër të mjaftueshëm të produkteve të sigurimit dhe të siguruesve të pranishëm në treg. Qëllimi

është t'Ju ofrohet një produkt i sigurimit i cili të përputhet me nevojat Tuaja personale. Në lidhje me këtë rekomandimet bazohen edhe në kriteret si raporti shërbim-çmim, besueshmëria në trajtimin e dëmeve dhe besueshmëria në partnerin të sigurimit dhe përvoja e mirë e konsultimit me të siguruarit e tjerë.

7.2. Për sigurimin e jetës dhe nga aksidenti si dhe për hua, mund të ndërmjetësojmë përmes MV24® vetëm me kusht, se dëshmoni identitetin Tuaj me një dokument të vlefshëm me fotografinë Tuaj, që u përgjigjet kushteve të kartës së identitetit në shtetin Tuaj. Për kite qëllim përveç mundësisë për vërtetimin e identitetit në bisedë individuale me ne, ekziston mundësia për zhvillimin e një procesi të njohur (nga partneri i sigurimit) të identifikimit (p.sh. aplikacioni Postident). Nëse dëshironi të lidhni kontratë së sigurimit në këtë kuptim, ne do t'Ju ndihmojmë në vërtetimin e identitetit Tuaj me anën e realizimit të një takimi personal për konsultim ose me anën e pjesëmarrjes në metodën e njohur të identifikimit (p.sh. aplikacioni Postident).

## **8. Përgjegjësia**

8.1. Me gjithë se përiqemi të garantojmë një disponueshmëri maksimale të MV24® dhe të eliminojmë maksimalisht shpejt problemet eventuale, sipas gjendjes së teknikës, nuk është e mundur të krijohet një program plotësisht pa gabime. Nuk mund të pretendohet për disponueshmërinë e vazhdueshme dhe të përhershme të MV24®. Ne nuk marrim përgjegjësi për dëmet (veçanërisht shkelje të detyrimeve shtesë), të shkaktuara nga shkelja me pakujdesi të detyrimeve. Kufizimet e përgjegjësive dhe përjashtimi i përgjegjësive nuk vlejnë për rastet e lëndimit të jetës, trupit ose shëndetit, të cilat bazohen në shkeljen faktore të detyrimeve. Përveç kësaj nuk preket përgjegjësia për dëme të tjera të shkaktuara nga pakujdesia e rëndë ose shkelja e detyrimeve me paramendim.

8.2. Ne mbajmë përmbytjen MV24® aktuale përmes azhurnimeve. Por korrektësia dhe aktualiteti i informacioneve të paraqitura në MV24® dhe në <https://www.mv24.de> nuk mund të garantohen. Nuk merret përgjegjësi për këtë. Ruajmë të drejtën tonë të ndryshojmë përmbytje dhe informacione dhe të heqim përmbytje dhe informacione nga MV24® ose nga faqja e internetit. Për gabimet e palëve të treta, veçanërisht për saktësinë e llogaritjeve në krahasimet, për të dhënat e produkteve ose kushtet e sigurimit të sigurveve ose të partnerëve të tjerë kontraktues gjithashtu nuk mbajmë përgjegjësi. E rezervojmë të drejtën tonë të ndryshojmë përmbytje dhe informacione dhe të heqim përmbytje dhe informacione nga MV24® ose nga faqja e internetit.

8.3. Ne nuk mbajmë përgjegjësi për gabimet e palëve të treta që punojnë për Ju, veçanërisht në lidhje me saktësinë e llogaritjeve elektronike, për të dhënat e produkteve ose kushtet e shoqërive të produkteve ose të partnerëve të tjerë kontraktues. Ne nuk mbajmë përgjegjësi edhe për përmbytjen e lidhjeve të dhëna nga palët e treta dhe të publikuara në MV24®.

## **9. Mbrojtja e të dhënave personale**

9.1. Me MV24® transmetohen dhe ofrohen të dhëna personale. Për këtë qëllim Ju deklaroni pëlqimin Tuaj që informacionet e dhëna të përdoren sipas dispozitave në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale (shih deklaratën për mbrojtjen e të dhënave personale).

9.2. Nëse ndërpritet përdorimi ose me dëshirën Tuaj ne do të fshijmë të gjitha të dhënat Tuaja sipas rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo nuk përfshin të dhënat që janë të

nevojshme për menaxhimin shtesë të kontratave Tuaja ose për zbatimin e detyrimeve ligjore të ruajtjes.

## **10. Marrëveshjet shtesë, ligji i zbatueshëm**

10.1. Kemi të drejtën të ndryshojmë në të ardhmen Kushtet aktuale të përdorimit, për sa këto ndryshime janë të nevojshme. Ju do të njoftoheni me kohë për ndryshimet përmes informacionit në MV24® me shkrim, me postë elektronike ose në ndonjë mënyrë tjetër. Ndryshimet konsiderohen të pranuar dhe janë të detyrueshme me hyrjen e tyre në fuqi për marrëdhëniet ekzistuese kontraktuese, nëse nuk kundërshtoni brenda një muaji pas njoftimit me mesazh në MV24®, me shkrim ose me postë elektronike. Në këtë drejtim, tërheqim vëmendjen Tuaj mbi njoftimin për ndryshimet. Kundërshtimi Juaj duhet të na dërgohet brenda një muaji pasi të jeni njoftuar për ndryshimet

10.2. Kushtet e përdorimit mund t'i gjeni përkatësisht në versionin e tyre aktual në adresë [www.mv24.de](http://www.mv24.de).

10.3. Nëse ndonjë dispozitë e kushteve të tanishme është e pavlefshme ose praktika gjyqësore ose dispozitat ligjore bëhen të pavlefshme, kjo nuk cenon vlefshmërinë e Kushteve të tërësishme të përdorimit. Dispozita e pavlefshme duhet të zëvendësohet me një dispozitë që i përgjigjet më së miri ekonomikisht qëllimit në një mënyrë të vlefshme juridikisht. E njëjta gjë vlen edhe për mangësitë në dispozitat. Shmangia dhe/ose plotësimi i marrëveshjeve janë të mundshme vetëm me pëlqimin tonë të qartë me shkrim.

10.4. Marrëveshje dhe ndryshime shtesë bëhen vetëm me shkrim.

10.5. Për marrëdhëniet tregtare midis Jush dhe nesh zbatohet legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë, duke përjashtuar Konventën e OKB mbi kontratat për shit-blerjen ndërkombëtare të mallrave.

## **11. Përgjegjës**

MV24 OOD(SHPK) dhe Co. KD

In den Lindengärten 1

63073 Offenbach am Main